

DREJT LINDJES SË MEDH'HEBEVE: ndarja në *Ehlul-Hadith* dhe *Ehlur-Re'j*

Ndarja në *Ehlul-Hixhaz* (banorët, dijetarët e Hixhazit-zonës Mekke/Medine) dhe *Ehlul-Irak* (banorët, dijetarët e Irakut) që mbështetej në dallueshmërinë e pozitës gjeografike dhe të mësuesve prej të cilëve ushqeheshin ata, qysh nga periudha e dytë e emevitëve, në masë të madhe e të përshkallëzuar, fillon të zhvillohet në një ndarje të mbështetur në metodologji (*usul*).

Kështu, nga ndarja që më tepër e theksonte dallueshmërinë e vendit (të pozitës gjeografike) duke u shndërruar në një ndarje që theksin më tepër e vinte mbi dallueshmërinë e metodologjisë, tanimë *Ehlul-Hixhazi* filloi të quhej *Ehlul-Hadith* (dijetarët e hadithit), kurse *Ehlul-Iraku* u bë *Ehlur-Re'j* (dijetarët e arsyes). Krahas dallueshmërive në mendime të kohëve të mëhershme, në këtë periudhë diskutimet më të rëndësishme që dolën në pah kishin të bënin me veprimin me *hadithet mursel* (hadithe që transmetohen nga ndonjë tabiun pa u përmendur emri i transmetuesit sahabij; përgjithësisht hyn në grupin e haditheve me zinxhir të ndërprerë të transmetuesve), me vlerën që u jepej mendimeve të *sahabëve* (muslimanët që kanë jetuar bashkë me Muhammedin a.s.) e të *tabiunëve* (muslimanët që kanë jetuar me sahabët) si dhe me mendimet që silleshin rreth çështjes së *re'jit* (arsyes, logjikës).

Dallueshmëria metodologjike që në fillim ishte dallueshmëri gjeografike, nuk mund të thuhet se ajo ka bartur veti e karakteristika tërësisht gjeografike. Për shembull, njëri prej mësuesve të Imam Malikut i quajtur Rabiatur-re'j i takonte shkollës së Ehlur-Re'jit, kurse *fakihu* (juristi) esh-Sha'bi nga Kufeja, edhe pse herë pas here e përdor *kijasin* (analogjinë si mjet logjik), në fakt i takonte shkollës së *Ehlul-Hadithit*.

Tendencat kryesore të *Ehlul-Hadithit* (*Ehlul-Etherit*)

Personi të cilin *Ehlul-Hadithi* në lëminë e *fikhut* (të së drejtës islame) e merr për lider, është njëri prej shtatë fakihëve të njohur të Medines, Said bin el-Musejjebi. Edhe pse Said bin el-Musejjebi (v. 94/712) ishte imam i *Ehlul-Etherit*, kur e donte puna hidhte hapa që mund të quhen “guximtarë” saqë jepte *fetva* (përgjigje juridike) edhe me *re'j*. Ndërkaq, edhe pse ishte nga Kufa (qytet në Irak), esh-Sha'biu i takonte shkollës së

Ehlul-Etherit. Ehlul-Hadithi është përmendur edhe me emrat *As'habul-Hadith* dhe *As'habul-Ether* ose *Ehlul-Ether*.

Karakteristikat kryesore të *Ehlul-Hadithit* mund të radhiten si në vijim:

- a) Nuk e shihnin me sy të mirë përdorimin e *re'jit* dhe të *kijasit*. Vetëm në raste nevojë bënin *istinbat* (nxjerrje të vendimeve duke përdorur logjikimin).
- b) I iknin marrjes së vendimeve për çështjet që akoma nuk kishin ndodhur.
- c) Më tepër i përkushtoheshin tubimit të haditheve dhe mbledhjes së mendimeve të sahabëve e të tabiunëve. Të gjitha këto që i tubonin i quanin me termin *ether* (shumësi *athar*). Prandaj, sa herë që duhej të jepnin ndonjë vendim lidhur me çështjet e paraqitura, atyre në të shumtën e rasteve u mjaftonin këto *ethere*.
- ç) Nuk u jepnin rëndësi *fetvave* dhe *re'jeve* (mendimeve) që binin ndesh me këto *ethere*.

Si rezultat i këtyre tipareve të *Ehli-Hadithit*, lind kjo metodë e tyre në lëmin e fikhut:

- 1) Të veprohet me një ajet të qartë kur'anor që ka të bëjë me çështjen e diskutueshme. Nëse ajeti ka mundësi për t'u komentuar, ky komentim të bëhet në përshtatshmëri me mënyrën e komentimit të cilën e miraton sunneti.
- 2) Të ndiqet sunneti në çështjet për të cilat nuk ka ajet kur'anor. Me këtë rast, nuk është me rëndësi nëse sunneti është *mutevatir* (i përcjellur nga një grup transmetuesish të secilës gjeneratë) apo *âhâd* (i përcjellur nga një person i secilës gjeneratë; ndahet në: *mesh'hur*, *aziz* dhe *garib*), nëse me të kanë vepruar sahabët dhe fakihët më herët ose jo.
- 3) Në rast të mungesës së ndonjë vendimi në sunnet, të merret vendimi i miratuar nga një grup i sahabëve dhe tabiunëve; në raste mospajtimi midis tyre, të preferohet kriteri i dijes dhe devotshmërisë së tyre.
- 4) Së fundi, të merren shembujt e përngjashëm me frymën, qëllimin, direktivat dhe kërkesat e Kur'anit e të sunnetit dhe në bazë të tyre të jepet fetvaja.

Pas periudhës fillestare kur në shkallë të madhe u intensifikuan diskutimet ideore në lëmin e politikës (*hilafetit*, *imametit*), *i'tikadit* (besimit), hadithit dhe fikhut, në mes viteve 130-190 / 747-805 Ehlul-Hadithi i tejkalon kufinjt e Hixhazit dhe rrethinës së tij, ku e kishte mbaruar fazën e formimit fillestar dhe i cili Hixhaz ishte djepi i muslimanëve me prejardhje arabe, duke tërhequr ithtarë të vet e duke u vendosur edhe nëpër vise të tjera gjeografike. Ehlul-Hadithi, që nga shek. III hixhrij duke u medh'hebizuar në malikij, shafi'ij, hanbelij dhe dhahirij (davudij), arrinë të shpërndahet në të gjitha anët e botës muslimane.

Tendencat kryesore të Ehlur-Re'jit

Personi të cilin Ehlur-Re'ji e kanë konsideruar si lider të tyre, ka qenë Ibrahim en-Neha'iu (v. 96/714). Shumica e fukahave (juristëve) nga Kufa dhe medinasi Rabiaturre'ji kanë qenë ithtarë të kësaj rryme. Ehlur-Re'ji ndryshe është quajtur edhe As'habur-re'j, Ehlul-Kijas dhe As'habul-Kijas.

Karakteristikat kryesore të Ehlur-Re'jit janë si në vijim:

- a) Nuk nguronin nga përdorimi i re'jit dhe i kijasit, kurse sa i përket transmetimit dhe pranimit të haditheve ishin mjaft të kujdesshëm dhe të ngurtë. Arsye për këtë ata i paraqitnin qëndrimet e Hulefaur-Rashidinëve, e sidomos të hz. Umerit e të hz. Aliut, lidhur me transmetimin e haditheve si dhe rritjen e sajimit (fabrikimit) të haditheve.
- b) Projektonin ngjarje që akoma nuk kishin ndodhur dhe duke i aplikonin metodat e tyre mbi këto ngjarje fiktive, gjenin zgjidhje për to si dhe diskutonin rreth tyre.
- c) Nuk mjaftoheshin vetëm me shprehjet e dukshme të ajeteve dhe të haditheve, porse kujdeseshin mjaft edhe për shkaqet, qëllimet dhe urtësitë e tyre.
- d) Sa i përket tubimit të haditheve dhe ethereve, ishin pak më pak se Ehlul-Hadithi të angazhuar. I mbildhnin dhe i mësonin përmendsh vetëm hadithet që sipas tyre ishin të pranueshme.

Si rezultat i këtyre karakteristikave të tyre, lindin këto metoda në lëmin e fikhut:

- 1) Të mbështeturit në ajetet e qarta që kanë të bëjnë me temën në fjalë.
- 2) Të mbështeturit në *sunnetin sahih* (të vërtetë) që ishte në përputhje të plotë me kushtet e parashtruara nga ata.
- 3) Të mbështeturit në *ixhma'in* (konsensusin) e sahabëve e të tabiunëve.
- 4) Nëse nuk ekziston *ixhma'* për çështjen në fjalë, para së gjithash të mbështeten në mendimin dhe fetvanë e sahabiut prej të cilin kishin mësuar njohuritë fetare. Nuk lidheshin pas të gjitha mendimeve të një sahabiut të vetëm. Sa i përket mendimeve të tabiunëve, për ta nuk ishin obliguese.
- 5) Nëse nuk gjenin përgjigje në burimet e mësipërme, me anë të metodave të tyre të nxirrnin vendimin prej këtyre të përmendurave.

Ehlur-Re'ji nuk ka arritur të fitojë ndonjë autoritet të veçantë deri në kohën e Ebu Hanifes. Figurat më të njohura të Ehlur-Re'jit deri te Ebu Hanifeja janë njerëzit, shumica prej të cilëve kanë marrë mësim prej Abdullah bin Mes'udit, si Alkameja, Mesruku, Kadi Shurajhu, Said bin Xhubejri, mësuesi i Ebu Hanifes Hammad bin Ebi Sulejmani (v. 120/737). Burimin e njohurive të Ibrahim en-Nehaiut e përbënin fetvatë e Abdullah bin Mes'udit, vendimet dhe fetvatë e hz. Aliut si dhe vendimet e Kadi Shurajhut dhe të *kadive* (gjykatësve) të tjerë të Kufes. Kështu që këta kishin formuar një thesar të çmuar në lëmin e fikhut.

Përfaqësuesit e tjerë të Ehlur-Re'jit nuk kanë qenë me ndikim sa boshti Hammad-Ebu Hanife. Mirëpo me ta janë lidhur në forma të ndryshme. Kështu, dalëngadalë termi ehlur-re'j fillon të përdoret kryesisht vetëm për hanefinjt, ngase madje edhe Mu'tezilet si njëra prej degëve më të rëndësishme të Ehlur-Re'jit, me kalimin e kohës, ndoshta

pas Imam Maturidiut sidomos në Azinë e Mesme, janë shkruar brenda medh'hebit hanefij.

Ehlur-Re'ji që nuk përbëhej vetëm nga grupi i fakihëve, përgjithësisht ishte i përbërë nga *mevalinj* (muslimanë që nuk kishin origjinë arabe). Edhe ashtu Iraku dhe qendra më e njohur e tij qyteti Kufe, ishin viset ku më së tepërmi ishin vendosur ata. Kjo ishte edhe njëra prej arsyeve për dallueshmërinë e tyre nga Ehlul-Hadithi në lëmin e i'tikadit, politikës dhe fikhut.

Dimensionet e ndarjes

Ndarja në *Ehlul-Hadith* dhe *Ehlur-Re'j* është një dallueshmëri që do t'i japë kahje gjithë historisë së fikhut, e sidomos *usulit* (metodologjisë së të drejtës islame). Mospajtueshmëria kryesore ishte një dallim në të kuptuar, që kishte të bënte me vlerën e vërtetësisë së disa haditheve të transmetuara si dhe me kriterin e përodrimit të *re'jit* (arsyes). Ithtarët e të dyja botëkuptimeve tregonin kujdes të veçantë që të bënin dallimin midis vendimeve të përcaktuara me ajet dhe hadith dhe vendimeve të mbështetura në re'jet e tyre. Qëllimi i të gjithëve ishte ta kërkonin e gjenin të vërtetën, që gjithkujt t'ia dorëzonin të drejtën e tij brenda kornizave juridike dhe që njerëzve t'u ofronin lehtësimin e vërtetë që ua jep feja. Ndarja në *Ehlul-Hadith* dhe *Ehlur-Re'j* nuk është një ndarje që është paraqitur vetëm në lëmin e fikhut. Kjo ndarje, në të njëjtën kohë ose brenda kohës është hetuar dhe është paraqitur në mënyrë efektive edhe në lëmin e *i'tikadit* (çështjeve të besimit). Të dyja grupet, krahas veprave mbi fikhun, kanë shkruar edhe mjaft vepra mbi *i'tikadin* ose të tilla që bartnin tituj mbi besimin.

Brenda rrymave të *Ehlul-Hadithit* dhe *Ehlur-Re'jit* që kryesisht e kap preiudhën ndërmjet shek. II dhe III hixhrij, mund të flitet për grupimet e matura dhe ekstreme:

1) Ehlul-Hadithi i matur: *Muhaddithët* (shkencëtarët e hadithit) e mëdhenj më të njohur e përbëjnë grupin e matur të *Ehlul-Hadithit*. Këta, nuk e përfillnin fort *re'jin* dhe i kishin përçafuar qasjet e sahabëve e të tabiunëve të cilët nxitnin vetëm në veprimin me ajet dhe hadith. Për këtë arsye edhe shumë rrallë e përdornin *re'jin* e *kijasin* dhe nuk jepnin fetva pa qenë e domosdoshme. Nguronin të jepnin fetva dhe gjykime lidhur me ngjarjet që akoma nuk kishin ndodhur. Kryesisht kanë qenë të dhënë pas mbledhjes së haditheve dhe transmetimit të tyre. Krahas haditheve, këta i futnin në grupin e *ethereve* edhe mendimet e sahabëve e të tabiunëve. Hadithin dhe etherin këta i mbanin më lart se çdo lloj *re'ji*. Në vend që të lidheshin pas të gjitha mendimeve (medh'hebit) të një personi, lidheshin pas ethereve që ata i njihnin për të vërteta.

2) Ehlul-Hadithi ekstrem: Këtë grup e përbëjnë disa ithtarë të Mu'teziles dhe medh'hebi Dhahirij, të cilët në mënyrë të skajshme ishin kundër *kijasit* dhe *re'jit*. Dhahirinj, me kalimin e kohës pjesërisht i zbutin qëndrimet e tyre lidhur me *re'jin* dhe *kijasin* dhe e pranojnë një metodë që ata e quanin "delil".

3) Ehlur-Re'ji i matur: Është grupi të cilin kryesisht e përbëjnë hanefinj. Hanefinj, në masë të madhe e kanë përdorur *kijasin* dhe e kanë sistematizuar atë si metodë me rastin e nxjerrjes së vendimeve të Sheriatit. Ishin të prirur të gjenin zgjidhje për ngjarje

që akoma nuk kishin ndodhur apo për ngjarje fiktive. Krahas shprehjeve të dukshme të ajeteve dhe haditheve, rëndësi u jepnin edhe urtësive e qëllimeve të tyre.

4) Ehlur-Re'ji ekstrem: Ky është grupi që nuk pranon argument tjetër *naklij* (të transmetuar: ajet dhe hadith) pos ajeteve kur'anore ose që nën kushte mjaft të ngushta i pranojnë vetëm disa hadithe. Mu'tezilet e Basras dhe një grup i harixhinjve nuk i pranojnë kurrësi hadithet, qofshin ato edhe mutevatir, për burime të së drejtës. Ndërkaq një grup tjetër brenda *Ehlur-Re'jit* ekstrem, edhe pse nuk i refuzojnë në mënyrë të përgjithësuar të gjitha hadithet dhe etheret, por nga frika e dobësisë së tyre i kundërshtojnë edhe hadithet sahih (të vërtetë), nuk u japin këtyre rëndësinë e duhur; nga ana tjetër shkonin në skajshmëri kur ishte në pyetje *kijasi* dhe *istihsani* (braktisja e një vendimi / gjykimi të mëparshëm të lëshuar nga një jurist dhe preferimi i një tjetri vendim duke u mbështetur në ajet, hadith, ixhma, domosdoshmëri e të tjera arsye).

Afrimet e *Ehlul-Hadithit* dhe *Ehlur-Re'jit*

Përkundër krejt kësaj me sa u tha më lart, nuk është e drejtë që kjo ndarje të kuptohet si një ndarje absolute. Në mes palëve, edhe në periudhën fillestare kur janë hedhur themelet e medh'hebeve, po edhe në periudhat e mëvonshme kur janë formuar dhe ngulitur medh'hebet, gjithnjë ka patur takime dhe afrime shekncore, gjithnjë i kanë pranuar kritikën e njëri-tjetrit dhe në bazë të këtyre vërejtjeve e kritikave kanë bërë revidimin dhe përmirësimin e mendimeve e gjykimeve të tyre, qoftë të kishin të bënin *usulin* (bazën, metodologjinë) qoftë me *furu'in* (degët, çështjet dytësore të së drejtës islame).

Imamu A'dham Ebu Hanifeja dhe Imam Maliku, janë takuar me rastin e haxhxit e me raste të tjera udhëtimi dhe kanë ndërruar mendimet e njëri-tjetrit. Djali dhe disa nxënës të Ebu Hanifes kanë mësuar te Imam Maliku. Imam Maliku dhe juristi egjiptas Lejs bin Sa'di, përmes takimeve dhe shkrimeve të ndërsjella kanë blerë mendimet e njëri-tjetrit. Po kështu ka patur takime dhe diskutime midis nxënësve të Ebu Hanifes dhe Imam Shafiut. Të gjitha këto afrime e takime kanë kontribuar në masë të madhe në zhvillimin tolerant dhe të suksesshëm të trashëgimisë së fikhut.

Hapat paraprakë të medh'hebizimit

Fakihët (juristët) e kësaj periudhe kanë dhënë fetva për pyetjet që populli ua parashtronte atyre. Populli i besonte njërit prej dijetarëve që jetonte në rrethin e tij, mirëpo akoma nuk ka patur një dukuri që mund të quhej "medh'heb" (shkollë juridike). Megjithatë, diskutimet metodologjike që janë zhvilluar në këtë kohë, po thuajse kanë qenë diskutime që i kanë dhënë kahje gjithë historisë së fikhut e të mendimit islam. Diskutimet lidhur me kuptimin dhe sqarimin e Kur'anit e të sunnetit, diskutimet lidhur me vërtetësinë dhe dimesionet e sunnetit, diskutimet lidhur me obligueshmërinë e mendimeve të sahabëve, diskutimet lidhur me të kuptuarit dhe dimensionin e *re'jit*, në fakt kanë qenë diskutime që zhvillohen akoma sot e kësaj dite dhe që i kanë dhënë shtytje përpara dhe një karakter dinamik mbarë mendimit islamik.

Këto diskutime, duke ndikuar në shkallë të parë në lindjen dhe sistematizimin e medh'hebeve, në fakt kanë krijuar bazën e vërtetë ideore për formimin e tyre. Qarqet shkencore të medh'hebeve të periudhës pas sahabeve kanë qenë të përbëra nga këta juristë të mëdhenj.

Ndarja në *Ehlul-Hadith* dhe *Ehlur-Re'j*, që sado kudo fitoi një karakter sistematik si rezultat i veprimtarisë së dendur të imamëve muxhtehidë të katër medh'hebeve të drejta, shkaktoi përgjithësimin e mendimeve juridike po edhe vetë lindjen e medh'hebeve ashtu siç i njohim sot, edhe pse jo në masë të madhe sa zhvillimet e shek. IV hixhrij kur edhe paraqiten medh'hebet në kuptimin e plotë të fjalës me gjithë imamët e medhenj dhe nxënësit e tyre, me gjithë tërësinë e metodave për zhvillimin e shkencës së të drejtës islame (fikhut) dhe me gjithë ndjekësit e këtyre imamëve e mendimeve të tyre nga ana e masave të gjera të muslimanëve.

**Nga turqishtja:
mr. Rejhan Neziri**